



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 586/2 Prot.

Tiranë, më 24 / 04 / 2019

V E N D I M

Nr. 55 , Datë 24 / 04 / 2019

Mbështetur në nenin 32/1/a të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 37 regj, datë 15.04.2019, e P. L kundër KMCA¹ Epror në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se, jeton në kushte shumë të vështira ekonomike. Ai shprehet se vuan nga çrregullime depresioni, rri mbyllur në shtëpi, nuk ngrihet nga krevati dhe nuk kujdeset dot për vehten. Në vijim citon se: “*Jam*

¹ Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë.

diagnostikuar me debilitet neuroinflexio, vërtetuar me raportin mjeko-ligjor të datës 10.06.2008. Po me vendim të Komisionit mjeko-ligjor të datës 12.08.2014 jam diagnostikuar me çrregullime mendore. Të njëjtën diagnozë më ka përcaktuar dhe Komisioni i Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor nr.3, i cili më ka diagnostikuar me prapambetje mendore dhe çrregullim psikopatik. Këto dokumnta i kam paraqitur në KMCAP, por ky institucion më ka kthyer përgjigje negative për mospërfitim të pagesës së aftësisë së kufizuar”. P. L ka pretenduar se vendimet e KMCAP janë të padrejta, dhe lidhur me këtë fakt ai ndihet i diskriminuar.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri shqyrtimin e vendimit të KMCAP Epror, pasi e konsideron vendim të padrejtë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD, konstatohet se:

- KMCAP i DRSSH Tiranë, me vendimin e datës 17.01.2019 ka caktuar se P. L plotëson kushtet për të përfiturar të ardhura për invaliditet pa grup, pasi vuan nga sëmundja: *“prapambetje e lehtë me çrregullime përshtatjeje”* dhe ka vlerësuar se është i aftë për punë të lehta.

- KMCAP Epror, me vendimin nr.42, datë 15.03.2019 ka caktuar se P. L plotëson kushtet për të përfituar të ardhura për invaliditet pa grup, pasi vuan nga sëmundja: *“prapambetje e lehtë mendore”* dhe ka vlerësuar se është i aftë për punë të lehta.

Lidhur me pretendimet e subjektit ankues, për kundërshtimin e vendimit të Komisionit Epror të Caktimit të Aftësisë për Punë, Komisioneri informon subjektin ankues, se vendimi i këtij Komisioni është i formës së prerë. Rimarrja në shqyrtim e vendimeve të këtij organi nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi².

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Për sa më sipër, referuar nenin 33/4/ç, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Neni 42 i Kushtetutës vendos standarde kushtetuese si për gjykatat, ashtu dhe për organet e administratës publike. Pika 2 e po këtij neni, sanksionon se kushdo mund t’i drejtohet gjykatës për të mbrojtur një të drejtë, liri apo interes kushtetues e ligjor. Kjo dispozitë, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cënim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar dhe rastin kur cënimi vjen dhe nga një akt administrativ i tillë.

Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 39/1 “Ankimimi në Komisionin Epror”, në pikën të 3 të tij, ka përcaktuar se: *“Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë”*.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjin 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, t’i drejtoheni Gjykatës Administrative të

² Për analogji citojmë: Vendimin nr.118, datë 07.05.2018 dhe Vendimin nr.185, datë 28.09.2018 të KMD, publikuar në web-in e institucionit: www.kmd.al

Shkallës së Parë Tiranë për të kundërshtuar vendimin e KMCAP Epror, i cili është i formës së prerë por nuk është i formës përfundimtare.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32/1, germa a), nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç, dhe 10, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës së P. L, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
2. Komisioneri i rekomandon subjektit ankues t’i drejtohet për ofrimin e ndihmës ligjore falas, Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike³, ose Shërbimit Ligjor Falas⁴.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: Aftësia e kufizuar

³Me adresë: Pranë Ministrisë së Drejtësisë, Blv. ‘Zogu i Parë’, Tiranë.

⁴Me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, 4 kullat, seksioni III, Ap. 1A, Kutia Postare nr.69, Tiranë
Nr.tel.: 0422 53114